



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2244/4 Prot.

Tiranë, më 06.12.2024

VENDIM

Nr. 37, datë 06.12.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2244 prot., datë 17.10.2024 (vijuar me nr. 2244/2 prot., datë 07.11.2024), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë Sh. A. (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës datë 16.10.2024, depozituar pranë Autoritetit Publik, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Pasqyrat Financiare për vitet ushtrimore 2021, 2022 dhe 2023.*
2. *Raportet e auditimit të bilanceve për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023.*

Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it datë 16.10.2024, ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se: “...pasqyrat financiare për vitet ushtrimore 2021, 2022 dhe 2023 janë në proces auditimi nga auditorët dhe sapo të certifikohen, informacioni do t’ju vendoset në dispozicion...” .

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 2244 prot., datë 17.10.2024 duke sqaruar se: “...Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, në vitin 2022 më ka vendosur në dispozicion bilancin financiar të vitit 2021...” .

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2244/1 prot., datë 17.10.2024, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 2244/3 prot., datë 12.11.2024, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi z. _____, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. Elisa Dedja, në cilësinë e koordinatorit për të Drejtën e Informimit, znj. Klodiana Guci, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Ekonomik dhe personit përgjegjës për trajtimin e kërkesës si dhe z. Erion Marku si jurist pranë Autoritetit Publik, i qëndruan pretendimit se: “*...si dhe evidentohet dhe në ekstraktin e shoqërisë, KESH SHA, në cilësinë e shoqërisë aksionare me sistem administrimi me dy nivele, ushtron aktivitetin bazuar e në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Referuar dispozitave të ligjit, në nenin 134, janë përcaktuar organet e shoqërisë aksionare, ku parashikohet se një nga detyrat e Asamblesë së përgjithshme të aksionarëve është: neni 135/2 dh) miraton pasqyrat vjetore financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. Në kuadër të administrimit të shoqërisë, sa i përket veprimtarisë mbi pasqyrat financiare, Asambleja e Përgjithshme miraton pasqyrat financiare pasi merr në konsideratë mendimin e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve pasqyrat financiare në zbatim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, janë të detyrueshme për tu publikuar. Citojmë nenin 43.3 a): Regjistrimet e tjera të detyrueshme: Përvec sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe depozitojë aktet përkatëse: Pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Citojmë nenin 46.1: Regjistrimi i pasqyrave financiare: subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a” të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5 të këtij ligji, detyrohen në cdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së cdo viti financiar. Si dhe parashikohet në aktet ligjore, pasqyrat financiare*

paraqiten përpara këshillit mbikëqyrës pasi certifikohen nga auditues të jashtëm. Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme për hartimin dhe përbërësit e pasqyrave financiare, përcaktimin e standarteve kontabël të zbatueshme, do ti referohemi ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 11: Qëllimi i pasqyrave financiare: 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapita/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike. Neni 13: Përbërësit e pasqyrave financiare: 1. Pasqyrat financiare vjetore, përveç rasteve që parashikohen në mënyrë specifike nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit apo Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, minimalisht duhet të përmbajnë: a) pasqyrën e pozicionit financiar; b) pasqyrën e performancës (pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve); c) shënimet e pasqyrave financiare. 2. Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik, përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, hartojnë edhe pasqyrat, si më poshtë: a) pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse; b) pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare; c) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta. Neni 22: Depozitimi dhe publikimi i pasqyrave financiare: 1. Njësitë ekonomike brenda 7 muajve nga data e raportimit, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku kanë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, 2 Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik duhet të publikojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, edhe në faqet e tyre zyrtare të internetit, jo më vonë se 7 muaj nga data e raportimit. Neni 23: Përgjegjësitë 1. Organi i drejtimit ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi mbikëqyrës, në varësi të kompetencave që u njeh ligji, janë përgjegjës solidarë për të siguruar që pasqyrat financiare vjetore dhe raporti i ecurisë së veprimtarisë/raporti i konsoliduar i ecurisë së veprimtarisë të njësisë ekonomike, të hartohen dhe të publikohen në përputhje me kërkesat e këtij ligji, aktet në zbatim të tij dhe standardet e miratuara të kontabilitetit. Mbështetur në ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, parashikohen dispozitat që rregullojnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore. Në kuptim të këtij ligji, auditim ligjor, është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, a) nëse kërkohet nga ky ligj; b) kërkohet nga ligje të tjera. Neni 43: Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese: a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar; b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar, standardet kombëtare të kontabilitetit; c) shoqëritë me përgjegjesi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: d) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; e) shuma e të

ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh; f) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël. Pra në kuptim të legjislacionin të posaçëm, pasqyrat financiare për të paraqitur me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike, përpara se të publikohen duhen së pari të kryejnë auditimin ligjor, të miratohen para Këshillit Mbikëqyrës, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve dhe më tej kanë detyrimin për publikim. Si dhe kemi sqaruar, për të përfituar shërbimin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2021, KESH SH.A. ka kontraktuar auditues ligjor, por ende nuk ka marrë shërbimin e kërkuar. Me përfundimin e auditimit ligjor të vitit 2021, i hapet rruga për auditimin e viteve pas ardhës. Në konkluzion të sa sipër dhe në përgjigje të kërkesës së z. _____, KESH SH.A., ka të publikuar pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019, 2020. Sa i përket termit “bilanc”, nuk e gjejmë të pasqyruar në asnjë akt ligjor...”, pretendime të depozituara nëpërmjet postës elektronike me datë 25.11.2024.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik në seancën dëgjimore dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë Sh. A., është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: “1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI, si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, në mënyrë të tillë që të bënte dhe vlerësimin e interesit publik më të lartë. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me fushën e energjisë, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me prodhimin, importimin, shitjen, blerjen dhe akumulimin, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejet i lartë.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: “...pasqyrat financiare për vitin 2021,2022 dhe 2023, nuk mund të vendoset në dispozicion të ankuesit pa u certifikuar më parë nga audituesi i jashtëm i kontraktuar nga KESH SH.A...”, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron pasi, nuk u argumentua në asnjë moment se në cilën pikë të nenit 17 të LDI, mbështetet kufizimi.

Autoriteti Publik nuk paraqiti asnjë provë për të mbështetur argumentat e paraqitura, pasi vetë përfaqësuesit e Autoritetit Publik, pasi u pyetën në seancën dëgjimore të datës 20.11.2024, zhvilluar pranë Zyrës së Komisionerit, nëse pasqyrat financiare janë depozituar pranë ndonjë autoriteti tjetër, gjatë viteve të kaluara në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pohuan se pasqyrat financiare janë depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në një format elektronik, tabelë *exel*-i. Pohimi i mësipërm bie ndesh me pretendimet e depozituara, në të cilat përfaqësuesit e Autoritetit Publik, ngrenë pretendimin se, nëse pasqyrat financiare nuk certifikohen nga auditueset e jashtëm të kontraktuar nga kompania, këto pasqyra financiare nuk janë të sakta, të përdorshme dhe të publikueshme. Në pikën 2, të nenit 2, të LDI parashikohet se: “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Në kuptim të nenit të sipërcituar, pasqyrat financiare për vitet 2021, 2022 dhe 2023, të cilat Autoriteti Publik i ka depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të konsiderohen si informacion/dokumentacion, i prodhuar dhe i depozituar nga ana Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Sh. A.. Ndodhemi përpara faktit që Autoriteti Publik, e ka prodhuar dokumentacionin e kërkuar, pasi është detyrim ligjor për kompaninë që në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij, ti depozitoj.

Pika 2 e nenit 2, të LDI, përcakton qartë se ç’do informacion i *prodhuar* apo *administruar* nga Autoriteti Publik gjatë ushtrimit të funksioneve të tija publike, do të konsiderohet dokumentacion publik, në kuptim të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, rrjedhimisht duhet vënë në dispozicion të kërkuarit në formën, qoftë elektronike apo shkresore, që Autoriteti Publik e disponon, gjithmonë duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Për sa shpjeguar më sipër, Autoriteti Publik, duke vlerësuar dhe hierarkinë e akteve ligjore, nuk mund të refuzoj dokumentacionin duke dhënë si shkak faktin se: “...*audituesi i jashtëm ende nuk ka certifikuar pasqyrat financiare, edhe se këto janë detyrim ligjor që të auditohen dhe certifikohen në zbatim të ligjit për shoqëritë tregtare...*”, por duhet t’i vendoste ato në dispozicion të kërkuarit duke specifikuar faktin se, këto pasqyra financiare, nuk do të ishin definitive dhe se mund të kishte ndryshime në to, pas auditimit dhe certifikimit nga shoqëria e ngarkuar për të kryer auditimin për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Në këtë kontekst, refuzimi në total i pasqyrave financiare, të depozituara nga Autoriteti Publik, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë

19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me arsyetimin e dhënë nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik, si gjatë seancës dëgjimore si nëpërmjet parashtrimeve të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit, vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Qëndrimi i mësipërm, njëkohësisht evidenton znj. Klodiana Guci, Drejtor i Departamentit Ekonomik dhe person përgjegjës për trajtimin e kërkesës, në shkelje të dispozitave të parashikuara nga neni 15 dhe 17 të ligjit të sipërpërmëndur, pasi do të konsiderohet se ka refuzuar dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, pa e arsyetuar dhe mbështetur në parashikimet e nenit 17 të LDI.

Sic është përmendur dhe më lartë, informacioni i kërkuar lidhet me veprimtarinë ekonomike në fushën e tregtimit të energjisë, ndaj interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me çështjen në këtë rast është tejet i lartë.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: “... Sa i përket termit “bilanc”, nuk e gjejmë të pasqyruar në asnjë akt ligjor...”, duke iu referuar termit të përdorur nga ankuesi në kërkesën e tij, Komisioneri vlerëson se në zbatim të nenit 12 të LDI, Autoriteti Publik, në rast se kërkesa për informacion ishte e paqartë, në zbatim të pikës 1 të nenit të sipërcituar i cili shprehet se: “...Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës...”, duhet të kishte kontaktuar direkt me ankuesin duke i kërkuar të bënte sqarimet e nevojshme mbi objektin e kërimit dhe jo të përgjigjej nëpërmjet e-mail-it të datës 16.10.2024, në të cilin e sqaron se: “...pasqyrat financiare për vitet ushtrimore 2021, 2022 dhe 2023 janë në proces auditimi...”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Për sa i përket pikës së dytë të kërkesës për informacion: “Raportet e auditimit të bilanceve për vitin 2021, 2022 dhe 2023.”, autoriteti publik deklaroj gjatë hetimit administrativ se: “...dokumentacioni i kërkuar nuk është prodhuar ende pasi shoqëria e kontraktuar për auditimin e jashtëm, është ende duke audituar bilancet financiare të vitit 2021, 2022 dhe 2023, dhe si pasojë nuk ka dorëzuar ende asnjë dokumentacion lidhur me auditimin dhe certifikimin e këtyre pasqyrave financiare, si rrjedhojë nuk mund ta vendosim në dispozicion pasi nuk e disponojmë dokumentacionin e kërkuar...”.

Komisioneri vlerëson, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI, se ankesa e z. _____, duhet të rrëzohet për këtë pikë, pasi dokumentacioni i kërkuar ende nuk është prodhuar dhe nuk disponohet nga Autoriteti Publik.

Në përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “*Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisé*”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës së z. _____, nr. 2244 prot., datë 17.10.2024, ndaj Autoritetit Publik, Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë Sh. A., me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 16.10.2024, konkretisht për pikën e parë: “*Pasqyrat Financiare për vitet ushtrimore 2021, 2022 dhe 2023.*” dhe për pikën e dytë: “*Raportet e auditimit të bilanceve për vitin 2018, 2019, 2020.*”, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 16.12.2024.
3. Rrëzimin e ankesës së z. _____, për pikën e dytë: “*Raportet e auditimit të bilanceve për vitin 2021, 2022 dhe 2023.*”

4. Dënimin e znj. Klodiana Guci, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Ekonomik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoba ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, 2 dhe 3, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
6. Kundër vendimmarrjes në pikën 4, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
7. Ky vendim u shpall sot në datë 06.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi